# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-477641**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Trump reagon për pesë të arrestuarit në Britani: U befasova që u liruan, nuk do ta bëja këtë |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/28/trump-reagon-per-pese-te-arrestuarit-ne-britani-u-befasova-qe-u-liruan-nuk-do-ta-beja-kete/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 20:22:33 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 28 shtator 2026, 20:18:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 28 shtator 2026, 20:17:00 UTC → 28 shtator 2026, 20:19:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9563f6c7d5321107b15e0740a12aebe2f2d892cd4529cb577c94b3b242c5a38b` |
| TEKSTI | `9dfaa909d55866cc44ada909745a0fb20b76ab14e76db34333517a157e657049` |
| PAMJA | `166f4c8f63daa61fc4d958b9acdbfbd9e48eac24e86a19e3022c85ff7dd47a75` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `150326fae4b35486e725936e3f127b6a827f9c6be2dcbc78feba429289a88754` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `6a4afcda2fdbaa1fd2c3f5e26c1cb3946785567999c2c435268418bbbef9bbb6` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/150326fae4b35486e725936e3f127b6a827f9c6be2dcbc78feba429289a88754`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA | TË FUNDIT

# Trump reagon për pesë të arrestuarit në Britani: U befasova që u liruan, nuk do ta bëja këtë

28/09/2026 22:18



**Presidenti amerikan Donald Trump ka reaguar ndaj lirimit me kusht të pesë shtetasve britanikë të arrestuar pranë një baze ajrore të përdorur nga ushtria amerikane në Britani, duke thënë se ai nuk do t'i kishte liruar.**

"Isha i befasuar që u liruan, nuk do ta bëja këtë", u tha Trump gazetarëve në Zyrën Ovale, duke iu referuar pesë britanikëve të arrestuar me dyshimin për planifikimin e një sulmi ndaj bazës.

Pesë të dyshuarit, të moshave 23 deri në 25 vjeç, u liruan me kusht më herët gjatë ditës, por mbeten nën hetim.

"Nuk do t'i lija të shkonin", tha Trump, duke shtuar se ishte befasuar nga vendimi për lirimin e tyre.

Gjatë bisedës me gazetarët, Trump foli edhe për luftën me Iranin. Ai tha se zyrtarët amerikanë kanë zhvilluar sot bisedime me ndërmjetës që po përpiqen t'i japin fund konfliktit, ndërsa përsëriti se Shtetet e Bashkuara do ta fitojnë luftën "shumë shpejt".

"Ne do të fitojmë, në një mënyrë ose në një tjetër. Do të ndodhë shumë shpejt", u shpreh presidenti amerikan.

Trump përsëriti gjithashtu se çmimi i karburantit do të bjerë ndjeshëm pasi SHBA-ja ta fitojë luftën.

Presidenti amerikan foli edhe për marrëdhëniet tregtare me Kanadanë, duke thënë se një marrëveshje tregtare mes dy vendeve përfundimisht do të arrihet. Sipas Trump, kanadezët "vazhdojnë të telefonojnë" dhe duan një marrëveshje.

Ndërkohë, Trump njoftoi ndërtimin e një fabrike të madhe çeliku në Iowa nga kompania Mesabi Metallics. Ai tha se objekti do të jetë "më i madhi" në historinë e Shteteve të Bashkuara.

Investimi kap vlerën e 18 miliardë dollarëve dhe fillimisht pritet të krijojë 6 mijë vende pune gjatë ndërtimit të uzinës. Në planin afatgjatë, fabrika pritet të krijojë edhe 2 mijë vende pune në këtë industri.

Trump, i cili po kritikohet për performancën e tij ekonomike vetëm disa javë para zgjedhjeve të mesit të mandatit për rinovimin e Kongresit, këmbënguli se ekonomia amerikane "nuk ka qenë kurrë në një gjendje më të mirë".

**Top Channel**

## Kryesore



Investigimi i Fiks Fare/ "Nëse Bela çon emrin…", Belinda Balluku ministre edhe pas shkarkimit. Dëshmitë ekskluzive të drejtoreve për "shefen"
20:50

Kuvendi i Kosovës miraton deklaratën për ish-krerët e UÇK-së: Kundërshtojmë aktgjykimin e padrejtë
12:58

"Shtatë kandidatë për BE, sa fëmijët e Ursulës"/ Ironia e Ramës: Von der Leyen nuk u tha vajzave "shko me gangsterin rus" apo "luaj me lodrat kineze"
11:06

Puna e bërë duhet t'i njihet Shqipërisë"/ Zyrtari i lartë i BE, McAllister: Parlamenti Europian do vijojë mbështetjen
12:22

"Kujdes!"/ Autoriteti për Sigurinë Kibernetike ngre alarmin për WhatsApp: Po komprometohen llogaritë në rajon, ja si të mbroheni
10:15

## Më të lexuarat

"Taulant Balla jam, më duhen 100 mijë euro", si tentuan dy të rinjtë të mashtronin Armand Dukën, agjenti i infiltruar iu prezantua si djali i kreut të FSHF

FOTOLAJM/ U shfaq për herë të parë në publik, kush është Elvis Lila, drejtuesi i SHISH i komanduar nga Rama

Presidenca zbardh mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe arkivon Vlora Hysenin: Drejtësia të bëjë punën e vet, çështjet individuale të mos cenojnë besimin te shteti

Fiks Fare/ "Belinda Balluku e ka vënë Enea Karakaçin". Drejtori i AKBN-së takime me ish-ministren deri në fund të gushtit: Do t'i çoj të fala

Detaje/ Mbyllet mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare pas 90 minutash diskutime, i pranishëm edhe kreu i SPAK

Investigimi i Fiks Fare/ "Nëse Bela çon emrin…", Belinda Balluku ministre edhe pas shkarkimit. Dëshmitë ekskluzive të drejtoreve për "shefen"

11 fëmijë, 7 gra, 3 Champions, 160 milionë të humbura, jeta e shfrenuar e Roberto Carlos

BE, një "surprizë" për Shqipërinë/ E zbulon "Politico", do ketë strategji më vete për 4 vendet që janë pranë anëtarësimit

"Kujdes!"/ Autoriteti për Sigurinë Kibernetike ngre alarmin për WhatsApp: Po komprometohen llogaritë në rajon, ja si të mbroheni

Mesazhe me përmbajtje seksuale me nxënësen 13-vjeçare, arrestohet mësuesi 60-vjeçar në Lushnje

## Bota »



Rihapet hetimi për akuzën e përdhunimit në grup në Universitetin Cornell, studentja pretendon se ishte droguar

28/09 22:16



"Kjo është beteja e fundit"/ Spotet e Trump ndezin polemika, opozita: Propagandë e paligjshme e paguar nga taksapaguesit

28/09 20:41



Vdekja e Mazonakis hap "kutinë e pandorës", kimioterapi pa licencë në klinikën e Selanikut, hetimet zbulojnë problematikat në spital

28/09 20:41



Lirohen pesë komplotistët/ U arrestuan se dyshoheshin për sulm ndaj bazës amerikane në Angli, dalin në liri me kusht

28/09 20:37



Dështon tentativa e hyrjes së 10 shqiptarëve në Angli me gomonen me motorë të fuqishëm

28/09 20:24



Të paktën 13 të vdekur pas shpërthimit në një fabrikë fishekzjarrësh në Rusi

28/09 20:13

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News- 'Ushtarët zëvendësohen, mbretëresha jo'/ Investigimi i Fiks Fare: Belinda ende ministre!



Top News – Territorialja, bashkitë e vogla kundër/ Belshi e Maliqi kundërshtojnë shkrirjen



Top News- Greqi–Turqi, rikthehet tensioni: Egjeu në prag të një përplasjeje të re



Lajmet kryesore të ditës – Top News, 29 Shtator 2026



Top News- Nga paga e shtetit te bizneset private, si ka lulëzuar pasuria e Ergys Verdhos ndër vite



Top News- Përse emri i Taulant Ballës përdoret nga mashtruesit për të zhvatur biznesmenët?!




© Top Channel 2001 - 2026 · Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.